

VENDIM
Nr.230, datë 23.3.2011

**PËR MIRATIMIN E DËMSHPËRBLIMIT FINANCIAR PËR ISH-TË DËNUARIT
POLITIKË TË REGJIMIT KOMUNIST**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenve 9 e 10 të ligjit nr.9831, datë 12.11.2007 “Për dëmshpërblimin e ish - të dënuarve politikë të regjimit komunist”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e dëmshpërblimit financiar për ish-të dënuarit politikë dhe për familjarët e të dënuarve, me dënim kapital, sipas listës të përfshirë në anekset “A”, “B” dhe “C”, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Masa e dëmshpërblimit për ish - të dënuarit politikë dhe familjarët e të dënuarve, me dënim kapital, të bëhet me këste, sipas kriterëve e kufijve të përcaktuar në nenin 12 të ligjit nr.9831, datë 12.11.2007 “Për dëmshpërblimin e ish - të dënuarve politikë të regjimit komunist”, të ndryshuar.

3. Shuma e llogaritur transferohet në një llogari speciale në Bankën e Shqipërisë. Pagesa e dëmshpërblimit për secilin përfitues bëhet nga Ministria e Financave, në llogaritë personale të këtyre përfituesve, të hapura në bankat e nivelit të dytë, të përzgjedhura, sipas nenit 33 të ligjit nr.9831, datë 12.11.2007, të ndryshuar.

4. Ngarkohen Ministri i Drejtësisë dhe Ministri i Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha